L I G J
Nr.9037, datë 27.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT TË KATËRT SHTESË TË MARRËVESHJES PËR FORCAT PAQERUAJTËSE SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli i katërt shtesë i Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3788, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

PROTOKOLLI
I KATËRT SHTESË I MARRËVESHJES PËR FORCAT PAQERUAJTËSE SHUMËKOMBËSHE PËR EUROPËN JUGLINDORE

Shtetet Palë të Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe për Europën Juglindore (MPFSEE), firmosur në Shkup, më 26 shtator 1998, e plotësuar dhe përmirësuar me protokollin e parë shtesë dhe firmosur në Athinë, më 12 janar 1999, e plotësuar me protokollin e dytë shtesë dhe firmosur në Bukuresht, më 30 nëntor 1999 dhe protokollin e tretë shtesë të firmosur në Athinë, më 21 qershor 2000:

duke rikonfirmuar angazhimin e tyre ndaj qëllimeve dhe parimeve të përfshira në Marrëveshjen e MPFSEE-së (Marrëveshja);

me vullnetin për të përmirësuar më tej Marrëveshjen për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore, për zgjerimin e iniciativës së MPFSEE-së dhe për të arritur nivele më të larta të ndëroperativitetit, duke përfshirë dispozita shtesë dhe duke rregulluar tekstet ekzistuese, procedurat dhe shkurtesat, me qëllim që ato të jenë në linjë me praktikat dhe terminologjinë e NATO-s,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Neni 1, paragrafi 1/o i Marrëveshjes është përmirësuar për t'u lexuar si më poshtë:

"Vendosje personeli (PE) nënkupton tryezën që rregullon strukturën rutinë organizative të autorizuar, si dhe kërkesat e personelit për stafe bazë të Shtabit të Lartë SEEBRIG".

2. Në nenin 1, paragrafi 1 i Marrëveshjes, përfshihet një nënparagraf i ri "e", i cili lexohet si më poshtë:

"e. "Planet e përgjithshme operacionale" nënkupton plane, të cilat zhvillohen për operacione të mundshme, ku disa nga faktorët planifikues (p.sh gama, forcat, destinacioni, rreziqet, fusha e përgjegjësisë etj.) nuk janë plotësisht të identifikuara ose nuk mund të parashikohen. Këto plane zhvillohen në nivelin e detajeve të kërkuara dhe identifikojnë kapacitetet e nevojshme".

Numri i nënparagrafëve në vazhdim ndryshon përkatësisht.

3. Neni 2, paragrafi 1 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

"1. Palët sigurohen se veprimtaritë e Forcës Paqeruajtëse të Europës Juglindore (MPFSEE) janë në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara".

4. Titulli i nenit 3 të Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

"Vendosje, dislokim dhe përdorim i brigadës së Europës Juglindore".

5. Neni 3, paragrafi 1 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

"1. Palët e përfshira, vendosin një komponent ushtarak të MPFSEE-së në nivel brigade, Brigadën e Europës Juglindore (SEEBRIG). Vendndodhja e Shtabit të Lartë SEEBRIG/stafit bazë do të përcaktohen me konsensus ndërmjet Palëve".

6. Neni 4, paragrafi 3 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshë:

"Takimet ministeriale të mbrojtjes do të rishikojnë subjektet ushtarake dhe marrin vendime/rekomandime sipas rastit, veçanërisht pjesëmarrjen në operacione, udhëzime të gjithanshme për angazhimin e SEEBRIG, ROEs, miratimin e planeve të përgjithshme operative dhe planet operative të paparashikuara. Ministerialet e mbrojtjes marrin vendime mbi dhënien e statusit të vendit vëzhgues".

7. Në nenin 4 paragrafët 1, 4, 5 dhe 16 të Marrëveshjes fjala "i përgjithshëm" është vendosur pas fjalës "mbrojtje" dhe fjala e përmirësuar është "shtabet e përgjithshme/të mbrojtjes".

8. Neni 4, paragrafi 6 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

"Një komitet drejtues politiko-ushtarak do të ngrihet dhe do të shërbejë si trupë e bashkuar ekzekutive për mbikëqyrjen dhe sigurimin e udhëzimeve politike për dislokimin, angazhimin dhe veprimtari të tjera të SEEBRIG".

9. Neni 4, paragrafi 12 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

"PMSC-ja do të përpunojë politika dhe udhëzime për miratime në ministeriale, të nevojshme për mundësimin e një funksionimi efektiv dhe angazhim të SEEBRIG, si dhe veprimtari të tjera të MPFSEE-së në fushat e mëposhtme".

10. Neni 4, paragrafi 14/a i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

"a. Miraton planet e përgjithshme operacionale dhe planet operacionale të paparashikuar të përgatitura në stafet bazë, sipas direktivave të ministrave të MPFSEE-së".

11. Në nenin 4, paragrafi 15/a dhe në aneksin E, neni 5, paragrafi 5 i Marrëveshjes fjala "miratim" është zëvendësuar nga fjala "paraqitje".

12. Neni 7, paragrafi 4 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

"Stafet bazë, në koordinim të ngushtë dhe në konsultim me shtabet e larta të vendeve respektive do të përpunojnë procedura operative të qëndrueshme, të dhëna bazë dhe obsione për lëvizjen strategjike të nevojshme për zvogëlimin paraprakisht të kohës së planifikimit dhe dislokimit në çdo rast dislokimi. Ai planifikon dhe përgatit drejtimin e trajnimeve dhe stërvitjeve operacionale dhe logjistike, bazuar në vendimet e komitetit drejtues politiko-ushtarak. Ai përpunon planet operative të përgjithshme dhe planet operative të paparashikuara. Merr pjesë në misione për gjetje faktesh, të cilat zhvillohen në përgatitjen për misionet që përfshijnë dislokimin dhe angazhimin e SEEBRIG".

13. Aneksi A, paragrafi 1 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet:

"Detajet e strukturës së SEEBRIG, të përcaktuara me paragrafët 1-4 në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, janë si më poshtë:"

14. Aneksi C, paragrafi 2/c i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

"Çdo shtesë ose zvogëlim në ndarjen e miratuar të posteve ose çdo ndryshim në ndarjen e miratuar të posteve duhet bërë me miratimin e ministrave të mbrojtjes së palëve me konsensus pas propozimit të PMSC-së".

15. Në aneksin E, neni 4, paragrafi 2 i Marrëveshjes pas "15 shtator PMSC" fjala "takim" është hequr.

Neni 2

1. Termi "Brigadë" është zëvendësuar me shkurtesën "SEEBRIG" në:

- Neni 1, paragrafi 1/s i Marrëveshjes
- Neni 3, paragrafët 2,6,7 dhe 8 të Marrëveshjes
- Neni 6, paragrafi 3 i Marrëveshjes

- Neni 7, paragrafët 2, 5 dhe 7 të Marrëveshjes
- Neni 11, paragrafi 2 i Marrëveshjes
- Neni 17, paragrafi 2 i Marrëveshjes
- Aneksi A, paragrafi 4 i Marrëveshjes
- Aneksi C, paragrafi 5/a (5) i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafët 1 dhe 1/c të Marrëveshjes
- Nenet 1, 2, 3 dhe 4 të protokollit shtesë të Marrëveshjes

2. Termat "Forcë" dhe "Forca" janë zëvendësuar me shkurtesën "SEEBRIG" në:
- Neni 3, paragrafi 3 dhe 5 i Marrëveshjes
- Neni 4, paragrafët 2 i Marrëveshjes
- Neni 6, paragrafët 1, 2, 4 dhe 5 të Marrëveshjes
- Neni 7, paragrafët 7 dhe 8 të Marrëveshjes
- Neni 8, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Neni 10, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Neni 11, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Neni 12, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Neni 15, paragrafi 2 i Marrëveshjes
- Aneksi A dhe C të Marrëveshjes, titujt.
- Aneksi A, paragrafi 10 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafi 1/c(3)/(d) i Marrëveshjes

3. Termi "Forcë HQ" zëvendësohet me termin "HQ SEEBRIG" në:
- Neni 4, paragrafët 12/f, 14/e, 15 f të Marrëveshjes
- Neni 7, paragrafët 1 dhe 3 të Marrëveshjes
- Neni 10, paragrafi 4 i Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 2, paragrafi 5 i Marrëveshjes

4. Shkurtesa "MPFSEE" zëvendësohet nga shkurtesa "SEEBRIG" në:
- Neni 9, paragrafi 3 i Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 5, paragrafi 10 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafët 1/c (1); 1/c (1) (d); 1/c (1) (e); 1/c (1) (g); 1/c (3) (d); 1/c (3) (h) të Marrëveshjes.
- Aneksi E, neni 4, paragrafët 1/a dhe 3/a të Marrëveshjes
- Aneksi -E, neni 5, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 9, paragrafi 1 i Marrëveshjes

5. Termat "MPFSEE HQ" dhe "HQ e MPFSEE" zëvendësohen me termin "HQ SEEBRIG" në:
- Aneksi B, paragrafet 3 dhe 4 të marrëveshjes
- Aneksi D, neni 1, paragrafët 2 dhe 4 të Marrëveshjes
- Aneksi -D, neni 2, paragrafët 2 dhe 4 të Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 3, paragrafët 1 dhe 2 të Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 4, titujt, paragrafët 1 dhe 2 të Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 5, 9, paragrafët 1, 2, 5, 6, 8, 10, 11, 12, 13, a dhe c; 14 dhe 15 të Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 6, paragrafët 1 dhe 2 të Marrëveshjes
- Aneksi D, shtesë 1, titujt e të Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafët 1/c (1) (b) dhe 1/c (c) të Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 4, paragrafi 1/a i Marrëveshjes

6. Shkurtesa MPFSEE zëvendësohet me shkurtesën "SEEBRIG" në:
- Aneksi C, paragrafët 5/a (7) (a) (i); 5/a (7) (a) (V) dhe 5/a (7) (a) (VI) të Marrëveshjes.

7. Termat "Shtab i përhershëm (PHQ) MPFSEE dhe "PHQ MPFSEE" zëvendësohen nga termi "HQ SEEBRIG" në:
- Aneksi E, neni 1, paragrafi 2 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafët 1; 1/c (1) (a); 1/c (1) (d); 1/d (1) dhe 1/h (4) të Marrëveshjes
- Aneksi E neni 4, paragrafi 1/b i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 8, paragrafi 1 i Marrëveshjes

8.Termi “Komandant brigade” dhe shkurtesat “COM/MPFSEE” dhe “COMMPFSEE” zëvendësohen nga shkurtesa “COMSEEBRIG” në:

- Neni 4, paragrafi 12/a i Marrëveshjes
- Aneksi B, paragrafët 2,5 dhe 6 të Marrëveshjes
- Aneksi C, paragrafët 5/a (5) dhe 5/a(6) të Marrëveshjes
- Aneksi D neni 5, paragrafi 4 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 2, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafët 1/c (1) (g) dhe 1/h (1) të Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 4, paragrafët 2/a, pas 31 korrikut dhe 2/b të Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 5, paragrafi 4, 5 të Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 7, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 8, paragrafi 2 i Marrëveshjes
- Neni 2 i protokollit shtesë të Marrëveshjes.

9. Termi “Organizim i veprimit” (ORACT) zëvendësohet me termin “radha e luftimit” (ORBAT) në:

- Neni 1, paragrafi 1/i i Marrëveshjes
- Neni 6, paragrafi 5 i Marrëveshjes
- Aneksi A, paragrafi 4, 5 dhe 6 i Marrëveshjes

10. Termat “Procedura standarde veprimi” zëvendësohet me termin “Procedura të qëndrueshme veprimi” (SOP) në aneksi C, paragrafi 4/b/(2)/(a) të Marrëveshjes.

11. Termi “Komandë operacionale” zëvendësohet nga termi “Kontroll operacional” në aneksi C, paragrafi 5/a (7)/b/(i) i Marrëveshjes.

Neni 3

1. Titujt e shtojcës aneksi A të Marrëveshjes janë përmirësuar dhe do të lexohen si më poshtë:
“Shtojcat
Shtojca –1: Struktura e përgjithshme SEEBRIG
Shtojca –2: Kontributi me trupa nga palët
Shtojca –3: Organizimi i SEEBRIG”.
2. Versioni i përmirësuar i shtojcës 2 të aneksit A të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
3. Versioni i përmirësuar i shtojcës 3 të aneksit A të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
4. Versioni i përmirësuar i shtojcës së aneksit B të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
5. Versioni i përmirësuar i shtojcës 1 të aneksit C të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
6. Versioni i përmirësuar i shtojcës 2 të aneksit C të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
7. Versioni i përmirësuar i shtojcës 3 të aneksit C të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
8. Versioni i përmirësuar i shtojcës 4 të aneksit C të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
9. Versioni i përmirësuar i vendndodhjes së shtabit të SEEBRIG-së dhe tabela e domosdoshme e vendeve me rotacion në protokollin shtesë së Marrëveshjes është bashkëlidhur.
10. Versioni i përmirësuar i aneksit A të protokollit të dytë shtesë të Marrëveshjes është bashkëlidhur.

Neni 4

1. Në aneksin C, paragrafi 2/e i Marrëveshjes, fjala “CE” është vendosur pas shkurtesës “PE”.
2. Aneksi C, paragrafi 4/b/2) i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë: “(e) përpunon “Plane të përgjithshëm operacionale (GOP) dhe plane operacionale të paparashikuara (COP)”.
3. Në aneksin C, paragrafi 5/c (1) i Marrëveshjes, fjala “të paktën” është vendosur mbas fjalës “vite”.

4. Në aneksin C, paragrafi 5/d i Marrëveshjes, paragrafët e mëposhtëm vendosen mbas nënparagrafit (1):
(2) DCOS OPS përgjigjet për zbulimin dhe kundërzbulimin, për operacionet e bashkëpunimit civilo-ushtarak dhe xhenion.

(3) DCOS SUP përgjigjet për personel, logjistikë, sistem informacioni, komunikimi, dhe financë.

Numërimi i nënparagrafëve do të ndryshojë përkatësisht.

5. Në aneksin E, neni 3, paragrafi 1/c (1) (g) i Marrëveshjes është hequr fjala "do të përpunohet".

6. Aneksi E, neni 4, paragrafi 2/a i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

"PMSC paraqet buxhetin dhe ja kalon atë ministrave".

Neni 5

1. Ky protokoll është pjesë integruese e Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore, e firmosur në shkurt, më 26 shtator 1998, e shtuar dhe e përmirësuar me protokollin shtesë të firmosur në Athinë, më 12 janar 1999, me protokollin e dytë shtesë të firmosur në Bukuresht, më 30 nëntor 1999 dhe protokollin e tretë shtesë të firmosur në Athinë, më 21 qershor 2000.

2. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit ose miratimit. Dhjetë (10) ditë mbasi katër palët kanë njoftuar depozitimin për plotësime të procedurave të tyre të brendshme, ky protokoll hyn në fuqi ndërmjet tyre. Për palët e tjera ai hyn në fuqi 10 ditë mbasi ata njoftojnë depozitimin për plotësimin e procedurave të tyre të brendshme. Dispozitat e nenit 3, paragrafët 2, 3, 6, 8 dhe 12 hyjnë në fuqi pasi ka hyrë në fuqi protokolli i dytë shtesë.

Në emër të shteteve palë të Marrëveshjes:

_____, Ministri i Mbrojtjes (shteti 1)
_____, Ministri i Mbrojtjes (shteti 2)
_____, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare (shteti 3)
_____, Ministri i Mbrojtjes (shteti 4)
_____, Ministri i Mbrojtjes (shteti 5)
_____, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare (shteti 6)
_____, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare (shteti 7)